

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE “TECHNOSYS” SH.P.K

Sot, me date 30.11.2022, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me te dhenat:

ORTAKET THEMELUES:

- **Rezart Veipi**, i biri i Namikut, lindur më 08.07.1976 në Vlore, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal H60708121M.

I cili, bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare » i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil si dhe ne vullnetin e lire te shprehur bie dakort dhe nenshkruan aktin e themelimit te shoqerise me termat ne vijim:

KREU 1
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA
NENI 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot ne date 30.11.2022 u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“TECHNOSYS” SH.P.K**
2. Themelues i shoqerise eshte:
 - **Rezart Veipi**, i biri i Namikut, lindur më 08.07.1976 në Vlore, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr.027132823 dhe nr. Personal H60708121M.

NENI 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

- a) Projektimi, instalimi, operimi, konsulence, trainime, mirembajtje e sistemeve te , prodhimit, prezantimit, transmetimit e monitorimit audio/vizual, TV, Radio, WEB-TV, IPTV, Tokesore, Satelitore, Kabllore, Hotel TV, Hospitality TV, A/V Conferencing, TCP-IP etj.
- b) Projektimi, instalimi, operimi dhe mirembajtja e sistemeve te komunikimit WebConference, E-Publishing, E-Learnig, E-Comunication, VOIP, WEB Pages, DataBase, Digital Asset Management, Digital Logging, Monitoring e Analyzing etj.
- c) Konsulence, trainime dhe sherbime ne fushen audio/vizive, telefoni, IT,



multimediale, internet, WEB TV, Radio, Produksion TV, Transmetim Satelitor, Tokesor, Kabllor, TCP-IP, Analog e Digital.

- d) Konsulencën, trainime dhe shërbime në fushën audio/vizive, telefoni, IT, multimediale, internet, WEB TV, Radio, Produksion TV, Transmetim Satelitor, Tokësor, Kabllor, TCP-IP, Analog e Digital
- e) Import-export, tregtinë me shumicë dhe pakicë të materialeve dhe paisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe aksesoreve të tyre, projektimin, instalimin, mirëmbajtjen e sistemeve elektrike dhe elektronike, trajnim personeli etj. Shërbime në assemblimin e pjesëve kompjuterike, të pajisjeve audio dhe video bashkë me programet përkatëse, të moduleve të programeve kompjuterike në programe të plota.
- f) Blerjen, marrjen e dhënien me qira apo në përgjithësi, shfrytëzimin e pasurive të paluajtshme, përdorimin e paisjeve të shoqërisë për prodhimin e artikujve të çdo lloji dhe dhënien e garancive personave të tretë.
- g) Realizimin e kontratave marëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar me persona fizikë dhe juridike shqiptare apo të huaj për të realizuar operacione industriale tregtare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe në interes të shoqërisë
- h) Cdo aktivitet tjetër të lidhur me aktivitetin kryesor.

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI 3 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri me afat te pacaktuar.

NENI 4 SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Kodra e Diellit, Ruga e Zallit, Nd. 98 Hyrja 1/1 Farke , Selite Tirane 1044 Tirane.

KREU II KAPITALI NENI 5 KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100.000 (njqind mije) leke i perbere nga nje kuote.

Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte perkatesisht:

- Ortaku **Rezart Veipi**, zoteron 100 % te kapitalit (1 kuote me vlere nominale te kuotes 100.000 leke)



Kontributi fillestar eshte likujduar teresisht nga Ortaku.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin te regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi prek ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

- 7.1 Kuotat e kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:
- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
 - b) Shitblerjes
 - c) Trashegimise
 - d) Dhurimit
 - e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.
- 7.2 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar, me kufizimet e percaktuara ne pikat 7.3 dhe 7.4 me poshte.
- 7.3 Ne rast se njeri nga ortakët kerkon te shese nje pjese ose te gjithë kuote qe ai zoteron ne shoqeri, ai eshte i detyruar qe t'ia ofroje paraprakisht keto per blerje, proporcionalisht, ortakeve te tjete te shoqerise, ose vete shoqerise me te njejtin çmim qe ai ka vendosur t'i shese ato. Kjo oferte do te quhet e marre nga ortakët e tjere dhe/ose nga shoqeria, ne momentin e depozitimit te saj ne seline e shoqerise.
- 7.4 Ne rast se ortaku/ ortakët e tjere te shoqerise, ose shoqeria, brenda 1 muaji nga data e depozitimit te ofertes nuk pergjigjen per kete oferte, ose refuzojne oferten, ortaku ofertues ka te drejte t'ia shese kuotat e tij paleve te treta lirisht.
- 7.5 Pergjegjesia e ortakeve per humbjet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimares i shoqerise. Ne momentine themelimit deri ne zoterimin e 100% te pjeseve te kapitalit prej nje ortakut organi me i larte administrativ eshte Ortaku i Vetem.



Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) Miratimi i bilanceve
- h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l) Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese, marrin pjese ne mbledhje ortakët, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetarët dhe Shoqerite tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese, ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumit te permendur ne paragrafin e mesiperem nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane **QKB** per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje afat 5 vjecar:

- **Rezart Veipi**, i biri i Namikut, lindur me 08.07.1976 ne Vlore, banues ne Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftim ID me nr. personal H60708121M.

NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim



- e) Krijohet nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te tretteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundershtrim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b) Me vendimet e asamblese se Ortakeve



- c) Me hapjen e procedurave te falimentit
- d) Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare et Regjistrimit,
- e) Me vendim gjykate.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

NENI 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegejsi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jete te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren.

Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22

MOSMARREVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rethit Tirane.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vullnet te lire te ortakut themelues.

ORTAKU THEMELUES:

Rezart Veipi

